

**AKTI I THEMELIMIT
DHE
STATUTI I SHOQERISE TREGTARE**

“MR KONSULENCE” SH.P.K.

Ne baze te Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe ne Ligjin nr. 9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, me date 16/06/2022, Ne te nënshkruarit:

1. **Mirela Bushi**, lindur në Korce , me datë 19.01.1967, dhe banues në Tirane, Njesia Bashkiake nr 2, Rruga Mustafa Aranitasi, Nr 4 me nr personal nr G75119105G, dhe nr karte identiteti 035192500
2. **Roland Bushi**, lindur në Lushnje, me datë 02.06.1961, dhe banues në Tirane, Njesia Bashkiake nr 2, Rruga Mustafa Aranitasi, Nr 4 me nr personal nr G10602020D, dhe nr karte identiteti 03609327 shpall si me poshte vijon:

**NENI 1
EMËRTIMI**

Formohet Shoqeria me përgjegjësi të kufizuar e quajtur “**MR KONSULENCE**” (me poshte do te quhet Shoqeria).

**NENI 2
SELIA E SHOQËRISË**

- 2.1. Selia zyrtare e Shoqerise Tregtare “MR KONSULENCE” Shpk., ndodhet ne adresen: Njesia Bashkiake nr 2, Rruga Mustafa Aranitasi, Nr 4, Zona Kadastrale 8190, Nr pasurie 11/1237, Tiranë, Shqipëri.
- 2.2. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë të transferojë selinë e Shoqërisë në një adresë tjetër. Organi administrativ i Shoqërisë mund te hape edhe seli te tjera operative, filiale, perfaqesi dhe agjenci ne te gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashte saj.

**NENI 3
KOHËZGJATJA**

Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike e Shoqerise eshte e pakufizuar.

**NENI 4
OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

- 4.1. Objekti i veprimtarise ekonomike i Shoqerise është:
Kontabilitetin, mbajtjen e llogarive, rishikimin, sherbimet e auditimit te jashtem;
Konsulencen per te gjitha entitetet ne sektorin privat, sektorin publik, organizatat jo



fitimprurëse, individët; Pergatitjen e planeve të biznesit; Sherbimet e auditimit të brendshëm; Sherbimet e pajtueshmërisë në përputhje me kuadrin e brendshëm dhe të jashtëm rregullativ për të gjitha subjektet pavarësisht formës ligjore; Dhenien e rekomandimeve për përmirësimin e biznesit dhe veprimtarive organizative; Kryerjen e vlerësimeve dhe/ose aktivitete të tjera që nuk ndalohen me ligj në Shqipëri; Keshilla tatimore, veprimtari juridike dhe aktivitete tjera; Sherbime të specializuara në fushën e tatimeve dhe taksave; Sherbime të specializuara për bizneset (pavarësisht nga forma e organizimit juridik) që lidhen me shkëmbimin, bashkimin, hapjen, mbylljen, riorganizimin, shitjen, transferimin dhe çdo nevojë tjetër në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm; Sherbime të specializuara për sektorin publik në përputhje me të gjithë termet e angazhimit dhe legjislacionin të zbatueshëm; Përfshirjen në projekte të ndryshme kombëtare apo ndërkombëtare si dhe implementimin e tyre duke përfshirë sektorin privat, publik, organizatat jo fitimprurëse, individët; Shërbime të hulumtimit dhe studimit të tregut për qëllime të brendshme dhe për palët e treta; Shërbime të asistimit në procesin e rekrutimit të stafit për palët e treta; Shërbime të asistimit në procesin e transferimit të asetëve (të prekshme dhe të pa prekshme) ndërmjet palëve të ndryshme; Shërbime të strukturimit të likuiditetit dhe asistim në përzgjedhjen e formave të ndryshme të financimit, plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm si dhe asistim në procesin e aplikimit; Shërbime për drejtimin dhe menaxhimin e entiteteve, lidhur me përcaktimin dhe përmirësimin e strategjive, përmirësimin e operacioneve, forcimin e kontroleve të brendshme, efikasitetin, efektivitetin. Shërbime të dizajnimit funksional dhe implementimit të programeve teknologjike për lehtësimin e nevojave të entiteteve përgjatë gjithë operacioneve të tyre si dhe për nevojat e raportimit. Shërbime të lidhura drejtpërdrejt ose jo me aktivitetet e përmendura në këtë nen si dhe çdo shërbim tjetër indirekt që lidhet me aktivitetet më 9 sipër që ka të bëjë me performancën e entiteteve, vijimësinë, trajtimin e problemeve të hasura, zgjerimin e veprimtarive, zgjerimit të tregut apo të shtrirjes gjeografike. Çdo shërbim tjetër i lejuar me ligj, përfshirë edhe konvertimet e mundshme gjuhësore apo interpretimin e atyre materialeve që lidhen me aktivitetet e mësipërme apo me kuadrin rregullator të brendshëm apo të jashtëm në formën e legjislacionit, standardeve, akteve, materialeve profesionale apo akademike si dhe raporteve, pasqyrave, formave të ndryshme të komunikimit, letrave dhe vendimeve të lëshuara nga palët e treta apo nga vet shoqëria. Në përputhje me Legjislacionin Shqiptar, me qëllim përmbushjen e qëllimit të sipërpërmendur, Shoqëria mund: Të mundësojë trajnim profesional për punëmarrësit e saj dhe palëve të treta për auditimin, kontabilitetin, legjislacionin fiskal dhe fusha të ngjashme, përfshirë dhënien e mbështetjes teknike në organizimin e trajnimit; Të kryejë aktivitete të konsulencës ekonomike dhe tregtare; Të mundësojë trajnim profesional për punëmarrësit e saj dhe palëve të treta për të gjitha aktivitetet e përmendura në objektin e këtij statuti si dhe çdo trajnim tjetër që lidhet me entitetet në sektorin privat, publik, organizatat jo fitimprurëse, individët në përputhje me kërkesat rregullative. Konsulencë ekonomike-financiare të shoqërive tregtare, Vlerësim të aktiviteteve tregtare, vlerësim të pasurive të luajtshme ose të paluajtshme."

- 4.2. Shoqeria kryen çdo lloj veprimtarie të dobishme për arritjen e objektivit të saj, duke përfshirë dhe pjesëmarrje direkte ose indirekte në kuota dhe aksione në shoqëri dhe ndërmarrje të tjera, Shqiptare ose të huaja, me aktivitetet të ngjashëm
- 4.3. Kjo Shoqëri mund të ndryshojë emërtimin e saj, vendqendrimin, objektin e aktivitetit, të shtojë ortakë apo të rrisë kapitalin sipas vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

5.1. Kapitali themeltar i Shoqërisë është prej 500,000 Lekë (peseqind mijë Lekë), në vlerë monetare para. Numri i pjesëve (kuotave) të kapitalit është 2 (dy) kuota. Kapitali i nënshkruar i paderdhur.

6.2. Pjesëmarrja në përqindje me vlerë përkatesisht :

1. Ortaku themelues Mirela Bushi zotëron 80% të kapitalit shoqërisë, një pjesë (kuote) me vlerë 400.000 leke (katerqind mijë Lekë)
2. Ortaku themelues Roland Bushi zotëron 20% të kapitalit shoqërisë, një pjesë (kuote) me vlerë 100.000 leke (njqind mijë Lekë)

6.3. Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

6.4. Asnjë nga ortakët nuk mund të transferojë kuotat respektive që kanë në Shoqëri pa miratimin me shkrim të ortakëve të tjerë. Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave të tretëve jashtë shoqërisë me miratimin e shoqërisë dhe të drejtë parablerjes në favor të shoqërisë apo ortakëve të tjerë. Brenda 30 ditësh nga oferta për blerjen e kuotave nga ortakët e tjerë, ata duhet të vendosin nëse do ta blejnë kuotën apo nëse janë dakort për transferimin apo shitjen e saj tek një i tretë sipas kërkesës së ortakut shitës.

6.5. Asambleja e Përgjithshme vendos për zvogëlimin ose rritjen e kapitalit të Shoqërisë.

NENI 6

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

6.1. Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme vendos për çdo çështje për të cilat është kompetente në bazë të legjislacionit shqiptar dhe këtij Akt Themelimit e Statuti.

6.2. Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, të shprehë vullnetin e tij dhe të votojë në përpjesëtim me pjesëmarrjen e tij në kuotat e Shoqërisë.

6.3. Secili ortak mund të caktojë një përfaqësues në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme. Përfaqësuesi mund të jetë një ortak tjetër ose një i tretë i autorizuar me shkrim.

6.4. Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë ose jashtë saj. Ortakët ose përfaqësuesit e tyre mund të marrin pjesë në mbledhjet e Asamblesë nëpërmjet mjeteve elektronike, duke përfshirë telekonferencat dhe/ose videokonferencat.

6.5. Asambleja e Përgjithshme thirret nga Administratori ose nga çdo ortak, në bazë të nenit 84 të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare". Thirrja e Asamblesë

së Përgjithshme duhet të bëhet me njoftim me shkrim, nëpërmjet telefaksit ose letrës rekomande, apo nëpërmjet postës elektronike dhe i njoftohet të gjithë ortakvë të paktën 7 (shtatë) ditë përpara datës së përcaktuar për mbledhjen. Njoftimi duhet të përmbajë çështjet e ditës për diskutim, vendin, datën dhe orën e mbledhjes.

- 6.6. Asambleja e Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajsh nga data e mbylljes së viti ushtrimor.
- 6.7. Për çështje të cilat vendosen me shumicë të thjeshtë votash, mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të jetë e vlefshme vetëm nëse në të marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që përfaqësojnë më shumë se 30% të kapitalit të Shoqërisë, në përputhje me nenin 86, pika , të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.
- 6.8. Asambleja e Përgjithshme, për ndryshime në Aktin e Themelimit dhe Statutit, rritjen ose zvogëlimin e kapitalit, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe shpërbërjen e Shoqërisë, vendos me $\frac{3}{4}$ e votave të ortakëve pjesëmarrës në mbledhje, në përputhje me nenin 87, pika , të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

NENI 7 ADMINISTRIMI

- 7.1. Shoqëria do të administrohet nga një ose më shumë administratorë, të emëruar për një periudhë maksimale prej 5 (pesë) vjetësh. Administratori caktohet në Statutin e Shoqërisë, dhe më pas emërohen, riemërohen ose shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme. Aktualisht, Shoqëria do të administrohet nga një Administrator.
- 7.2. Administratori gëzon të drejta të plota në drejtim të administrimit të Shoqërisë dhe mund të kryejë çdo veprim që e konsideron të nevojshëm për përmbushjen e objektit të Shoqërisë, përveç veprimeve që janë në kompetencë të Asamblesë së Përgjithshme apo të organeve të tjera të Shoqërisë. Administratori është përgjegjës për të gjitha veprimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë dhe gjithashtu mund të caktojë përfaqësues për kryerjen e veprimeve për llogari të Shoqërisë. Në çdo rast, caktimi i përfaqësuesit nuk e përjashton Administratorin nga përgjegjësia.
- 7.3. Asambleja e Përgjithshme vendos për shpërblimin e Administratorit.
- 7.4. Administratorët nuk mund të marrin borxhe nga Shoqëria apo të japin garanci në emër e për llogari të Shoqërisë në lidhje me borxhe apo investime të dhëna nga palë të treta.
- 7.5. Administratori do të veprojë gjithmonë në interesin më të mirë të Shoqërisë. Në rast konflikt interesi, Administratori do të njoftojë menjëherë ortakët, si dhe do të abstenojë nga përmbushja e ndonjë veprimi që lidhet me situatën e konfliktit të interesit deri në marrjen e udhëzimeve nga Asambleja e Përgjithshme.
- 7.6. Administrator i shoqërisë është Mirela Bushi, lindur në Korce , me datë 19.01.1967, dhe banues në Tirane, Njesia Bashkiake nr 2, Rruga Mustafa Aranitasi, Nr 4 me nr personal nr G75119105G, dhe nr karte identiteti 035192500, për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.



NENI 8
VITI FINANCIAR

Viti financiar i Shoqërise fillon në 1 Janar dhe mbyllet në 31 Dhjetor të cdo viti. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

NENI 9
KONTROLLI FINANCIAR

Kontrolli financiar i Shoqërisë do të kryhet nga Eksperti Kontabël i Regjistruar konform legjislacionit shqiptar në fuqi. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë Ekspert Kontabël të Regjistruar.

NENI 10
BILANCI VJETOR

Bilanci vjetor, raporti i administrimit, inventaret dhe llogaritë vjetore të hartuara nga eksperti Kontabël i Regjistruar i nënshtrohen miratimit të Asamblese së Përgjithshme brenda një afati prej 6 muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar.

NENI 11
DIVIDENTI

Në përputhje me dispozitat ligjore, Asambleja e Përgjithshme vendos mbi shpërndarjen e dividendit në bazë të rezultatit financiar të Shoqërisë.

NENI 12
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë mes ortakëve të Shoqërisë, administratorit, likuidatorit, Shoqërisë dhe të tretëve, do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 13
HARTIMI I AKTIT

Ky Akt themelimi dhe Statut hartohet në 2 (dy) kopje në gjuhën italiane dhe në 2 (dy) kopje në gjuhën shqip.

NENI 14
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin në përputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin, dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi. Përsa nuk është shprehur në këtë Statut, do të zbatohet ligji 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

ORTAKET E SHOQËRISË
"MR KONSULENCE" SHPK

1- Mirela BUSHI



2- Roland BUSHI

